



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA




RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS

SHTËRPECË

PARATË DHE POLITIKA



AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU



RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS

SHTËRËPCE

PARATË DHE POLITIKA



AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU





Implementing Persons and Organizations for this report:

MARIJA VELJKOVIĆ – Future Without Fear

ANA STALETOVIĆ – Future Without Fear

Financuar nga:



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA





Përshkrimi i projektit:

Ky projekt i mbështetur nga Advancing Kosovo Together – Local Solutions (AKT-LS) përmes USAID, ka për qëllim të rrisë integritetin e qeverive lokale duke shtuar monitorimin nga shoqëria civile në këto komuna. Pjesëmarrësit në këtë projekt janë aftësuar: të kenë qasje në informatat për tenderët publikë në nivel komunash, të identifikojnë lidhjet politike në mes të kompanive apo personave që kanë fituar tenderë por që më herët kanë qenë donator të partive politike, gjithashtu edhe verifikimin e deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë shtetëror. Pjesëmarrësit kishin për detyrë që këto njohuri t'i aplikojnë në komunat e tyre dhe të shkruajnë një raport mbi të gjaturat. Kjo punë reflekton njohuritë dhe metodologjinë e fituar nga trajnimi.

Deklaratë mohimi

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë punë e pjesëmarrësve në këtë projekt. Hulumtimi në këto raporte është vetëm punë e këtyre personave dhe jo e organizatave përfaqësuese. Ato gjithashtu nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve të këtij projekti, United States Agency for International Development (USAID). Këto pikëpamje gjithashtu nuk paraqesin qëndrimet e organizatave implementuese Communication for Social Development dhe Organizatës Çohu!.

Publikuar nga

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!
Rruga: Rustem statovci Nr.17; Prishtinë, Kosova
Tel / +381 (0)38 248 506
www.cohu.org

PËRMBAJ

08

Hyrja

10

Investimet
kapitale

10

Të gjeturat
kryesore

11

Mallra dhe
shërbime

TJA

27

Financimi i
subjekteve
politike

22

Raportet e
Auditimit

28

Përfundime dhe
rekomandime

27

Lidhjet e biznesit
me politikën



RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS SHËTËRËPÇË

HYRJA

Për shkak të problemeve teknike nuk kemi qenë në gjendje të marrim të dhëna nga vitet 2007-2009. Gjatë vitit 2010 në Komunën e Shtërpçës ka pasur disa raste ku kontratat janë nënshkruar përtej shumave të cilat ishin miratuar si dhe përtej shumave të cilat figurojnë në buxhetin e miratuar të Komunës. Gjithashtu, Komuna gjatë këtij viti ka hyrë edhe në borxhe.

Për vitin 2011 buxheti nuk bazohet në analiza të kaluara të nevojave dhe nuk përputhet me aktivitetet operacionale të komunës. Ka mungesë në hartimin me kohë të planeve të prokurimit dhe ekzekutimit të buxhetit. Si pasojë e kësaj paraqitet suficiti buxhetor, derisa ekziston mundësia që shumë nevoja reale të mbesin të papërbushura. Gjithashtu nuk ka kontroll sa i përket shpërndarjes së shpenzimeve sipas periudhave, dhe kjo ka rezultuar me shpenzimin e gjysmës së buxhetit në tremujorin e fundit.

Në dallim nga vitet e kaluara, në vitin 2012 Komuna e Shtërpçës ka arritur ta realizojë planin e saj buxhetor në nivel të kënaqshëm siç do të demonstron me tutje me të dhëna. Gjatë vitit 2013 fushat kryesore ku ka pasur më së shumti nevojë për përmirësim kanë qenë: prokurimi, subvencionet si dhe menaxhimi i pasurisë.

Në vitin 2014 Komuna e Shtërpçës ka realizuar 88% të buxhetit përfundimtar në raport me vitin e kaluar, pra 2013, ku është realizuar gjithsej 83%. Në bazë të kësaj mund të vijmë në përfundim se nga viti në vit Komuna e Shtërpçës ka përparuar dhe mund të vërehet se profesionalizmi i zyrtarëve të Komunës së Shtërpçës është rritur në një nivel më të lartë, gjë që edhe është pritur.

Nga të gjitha kompanitë të cilave u janë ndarë tenderët, kompanitë nga Komuna e Shtërpçës kanë përfituar 82 tenderë, me vlerë totale 2,694,039 €. Kjo paraqet 15.75% në raport me vlerën totale të të gjithë tenderëve në Komunën e Shtërpçës për periudhën 2010-2015.

Problemet kryesore të identifikuara gjithashtu në raportin e Auditorit Gjeneral për Komunën e Shtërpçës janë si vijon:

- Mos-respektimi dhe shkelja e dispozitave ligjore të Prokurimit Publik;
- Procedurat jo-efikase të Komunës në prokurimin publik në përputhje me rregullat ekzistuese të prokurimit;
- Favoret politike për ndërmarrjet në rastet e ndarjes së tenderëve;
- Nënshkrimi i kontratave në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik;
- Parregullsi në menaxhimin e kontratave të prokurimit;
- Të hyrat kapitale (aktivitetet si: lloji i pasurisë, fondi i privatizimit, lloji i të hyrave) të pa evidentuara nga Komuna;
- Tejkalmi i buxhetit të mjeteve vetanake, tejkalmi të programet e caktuara buxhetore siç është shëndetësia ku nuk kanë arritur të punësojnë staf të parashikuar me këtë buxhet;

- Komuna e Shtërpçës nuk e ka zbardhur plotësisht dhe saktësisht informacionin për pasurinë;
- Mungesa e zyrtarit për pasurinë i cili do të krijonte një regjistër të plotë të pasurisë dhe ta përditësonte vazhdimisht;
- Nuk janë barazuar të hyrat vetanake ndërmjet departamenteve dhe zyrtarëve të të hyrave;
- Nuk janë kryer pagesat e të hyrave të inkasuara në baza ditore në bankë;
- Komuna nuk ka pasur Plan përfundimtar të prokurimit publik për vitin 2011 me c'rast, ka munguar gjithashtu Rregullorja për ndarjen e subvencioneve;
- Mungesa e kontrollit në shpenzimet e Komunës;
- Mungesa e dokumentacionit komplet për ndarje të subvencioneve;
- Mos-zbatimi i rekomandimeve të Auditorit Gjeneral ndër vite;
- Raportet vjetore financiare të pakompletuar;
- Mungesa e dëshmive se vetura vërtetë është shfrytëzuar për nevoja zyrtare, përkundër faktit se janë paguar sasi e madhe e karburantëve;

TË GJETURAT KRYESORE

1 / Prokurimi publik

Komuna e Shtërpçës për investimet kapitale, mallra dhe shërbime për periudhën 2010-2015 ka alokuar fondet e planifikuara si në vijim:

1.1 / Kapitali i planifikuar në Komunë

Mjetet e planifikuara dhe të shpenzuara për investime kapitale



**INVESTIMET
KAPITALE**

PLANIFIKUAR
€ 2,529,916

SHPENZUAR
€ 2,537,046

2010

PLANIFIKUAR
€ 2,149,999

SHPENZUAR
€ 2,144,908

2011

PLANIFIKUAR
€ 2,195,030

SHPENZUAR
€ 2,147,005

2012

PLANIFIKUAR
€ 1,123,638

SHPENZUAR
€ 981,923


2013

PLANIFIKUAR
€ 922,230

SHPENZUAR
€ 847,049

2014

Mjetet e planifikuara dhe të shpenzuara për mallra dhe shërbime



Në bazë të raportit të Auditorit Gjeneral, Komuna e Shtërpcës për vitin 2010 ka planifikuar të shpenzojë gjithsej 2,707,824 € për investime kapitale dhe prokurim publik. Nga shumë e parashikuar, është shpenzuar 2,714,954 €, pra shpenzimet janë tejkaluar për 7,130 euro. Sa i përket kategorisë mallra dhe shërbime k, është shpenzuar aq sa është planifikuar, derisa te shpenzimet tjera kapitale është shpenzuar 7,130 € më shumë sesa që është planifikuar. Kjo diferencë vjen si pasojë e planifikimit të keq të mjeteve të cilat kanë qenë në dispozicion, thotë Zyra e Auditorit Gjeneral.

AUDITIMI

Në bazë të raportit të Auditorit Gjeneral, kemi ardhur në përfundim se mangësitë të prokurimi publik janë si vijon:

- Komuna e Shtërpcës nuk ka arritur të vendosë procedurë efikase të prokurimit publik të cilat janë në përputhje me rregullat ekzistuese të prokurimit;
- Aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar pa rezervim paraprak të mjeteve në sistemin Free Balance;
- Në Komunën e Shtërpcës ka gjithashtu disa raste të prokurimit publik për investime kapitale dhe shpenzime operationale ku data e nënshkrimit të kontratës me furnizuesin është më e hershme se data kur mjetet janë rezervuar në sistemin Free Balance;
- Ka pasur disa raste kur kontratat janë nënshkruar me kompanitë me vlerat përtej shumave të miratuara dhe atyre ekzistuese të miratuara në buxhetin komunal.

REKOMANDIMET E AUDITORIT JANË SI VIJON:

- Komuna duhet t'i përmbahet Ligjëve dhe Udhëzimeve Administrative të cilat janë aktualisht në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Auditori Gjeneral i ka rekomanduar Administratës së Komunës së Shtërpcës t'i respektojë në plotëni ligjet e aplikueshme në Kosovë, sidomos dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik në Kosovë;
- Përveç kësaj, Auditori Gjeneral i ka rekomanduar Administratës së Komunës së Shtërpcës që të sigurohet që asnjë prokurim të mos kryhet dhe që asnjë kontratë të mos nënshkruhet me vlera përtej shumave të buxhetit përfundimtar të Komunës.

2011

Në bazë të raportit të Auditorit Gjeneral, Komuna e Shtërpçës në vitin 2011 ka planifikuar të shpenzojë gjithsej 2,619,611€ për investime kapitale, mallra dhe shërbime. Nga shuma e parashikuar, gjithsej janë shpenzuar 2,485,280€. Dallimi prej 134,331€ ka mbetur i pashfrytëzuar.

AUDITIMI

Pas inspektimit të dokumentacionit për prokurim të zhvilluar të mallrave, shërbimeve dhe investimeve kapitale, Auditori ka theksuar si në vijim mangësitë e prokurimit publik dhe të shërbimeve:

- Sistemi i kontrolleve të brendshme të Komunës së Shtërpçës nuk është i dizajnuar në mënyrë adekuate në mënyrë që të eliminohen dobësitë ekzistuese, apo ky sistem nuk implementohet si duhet.
- Komuna e Shtërpçës nuk ka zbuluar plotësisht dhe me saktësi informata lidhur me pasurinë.
- Komuna nuk ka pasur ndonjë Plan përfundimtar të prokurimit publik për vitin 2011, dhe përveç kësaj ekziston edhe Rregullorja për ndarjen e subvencioneve.

REKOMANDIMET E BAZUARA NË RAPORTIN E AUDITORIT JANË SI VIJON:

- Raporti vjetor financiar të bëhet në përputhje të plotë me Dispozitën Financiare Nr. 07/2011
- Kompensimet për gjithë stafin të bazohen në Ligjet e aplikueshme dhe Udhëzimet Administrative në fuqi.
- Procedurat e prokurimit të jenë në përputhje me ZJN.
- Regjistrimi i pasurisë të jetë në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.21/2009

- Në bazë të raportit të Auditorit Gjeneral, Komuna e Shtërpçës në vitin
- 2011 ka planifikuar të shpenzojë gjithsej 2,619,611€ për investime kapitale,
- mallra dhe shërbime.

Në bazë të Raportit të Auditorit Gjeneral, Komuna e Shtërpçës në vitin 2012 ka planifikuar të shpenzojë gjithsej 2,651,432€ për investime kapitale, mallra dhe shërbime. Nga shuma e parashikuar, gjithsej janë shpenzuar 2,481,968€. Dallimi prej 169,464€ ka mbetur i pashfrytëzuar.

AUDITIMI

Në bazë të raportit të Auditorit Gjeneral kemi arritur në përfundim se mangësitë e prokurimit publik dhe të shërbimeve janë si vijon:

- Janë identifikuar një varg mangësish në fushën e prokurimit publik. Prokurimi jashtë kontratave dhe niveli i ulët i mbikëqyrjes janë vetëm disa prej mangësive që e kanë përcjellur procesin;
- Gjatë auditimit është vërejtur mungesa e dokumentacionit komplet për ndarjen e subvencioneve;
- Menaxhimi i keq me obligimet, dhe këtu, natyrisht, nënkuptohen kuadrot joprofesionale;

REKOMANDIMET E BAZUARA NË RAPORTIN E AUDITORIT JANË SI VIJON:

- Rekomandimi i parë është që përgatitja e Buxhetit të bëhet në bazë të analizës gjithëpërfshirëse të nevojave reale;
- Raporti vjetor financiar nuk pasqyron gjithë pasurinë, që është kërkesë reale, dhe me këtë t'i kompletojë informatat e nevojshme;
- Të bëjë përgatitjen e planit vjetor të prokurimit, duke specifikuar qartë të gjitha projektet dhe nevojat për furnizim dhe ta forcojë kontrollin dhe mbikëqyrjen e kontratës, në mënyrë që punët dhe furnizimet të kryhen brenda afateve të kontraktuara;
- Të nxjerrë Rregullore të brendshme, duke specifikuar qartë kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve, me qëllim të parandalimit të ndonjë parregullsie eventuale;
- Të kompletojë regjistrin e pasurisë, në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 21/2009 për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë;
- Të zhvillojë një rishikim funksional të kontrollit të brendshëm, për të parë nëse procedurat e kontrollit dhe identifikimi i rrezikut janë definuar në mënyrë normative, dhe nëse kanë krijuar zhvillim normal të shkëmbimit të informacioneve dhe të komunikimit brenda institucionit.
- JUR do të fokusohet kryesisht në përcjelljen e aktiviteteve të vitit vijues, dhe atë në problemet më problematike siç është prokurimi dhe pasuria, dhe të formojë një Komision për rishikim sa më shpejt që të jetë e mundur, me çka do të forcohej funksioni i auditimit të brendshëm;

Në bazë të raportit të Auditorit Gjeneral, Komuna e Shtërpçës në vitin 2013 ka planifikuar të shpenzojë gjithsej 1,621,3072€ për investime kapitale, mallra dhe shërbime. Nga shuma e parashikuar, gjithsej janë shpenzuar 1,421,189€. Dallimi prej 200,118€ ka mbetur i pashfrytëzuar.

AUDITIMI

Në bazë të raportit të Auditorit Gjeneral kemi ardhur në përfundim se mangësitë e prokurimit publik dhe të shërbimeve janë si vijon:

- Cilësia e dobët e menaxhimit financiar te menaxhmenti i lartë;
- Komuna nuk ka dëshmuar konsistencë në planifikimin e burimeve të të hyrave. Dallimet në tri vitet e fundit janë të theksuara, dhe atë për 70,000 € më pak se në vitin 2012, dhe 1/3 e vlerës së faturës së tatimit nuk është grumbulluar nga tatimpaguesit;
- Dobësitë e zakonshme në procesin e prokurimit publik;
- Proceset tjera të prokurimit janë karakterizuar me mangësitë specifike të kontrollit;

REKOMANDIMET E BAZUARA NË RAPORTIN EAUDITORIT JANË SI VIJON:

- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani sistematik për sajimin e raporteve financiare të përfshijë kërkesën për përfshirjen e gjithë vlerës së pasurisë;
- Pastaj duhet të sigurohet që plani i rishikuar i veprimit në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor dhe staf përgjegjës për adresimin e rekomandimeve së bashku me anëtarët e stafit të identifikuar përgjegjës me fokus fillestar në ato fusha të rëndësishme më të madhe;
- Duhet të ketë qasje gjithëpërfshirëse për trajtimin e të hyrave, si në aspektin e planifikimit ashtu edhe në atë të vendosjes së mekanizmave efikasë për zbatimin e parametrave të planifikuara;
- Kryetari i Komunës do të duhej të siguronte që të kryhen përputhja e stafit për gjënerimin e të hyrave dhe e stafit të Shërbimit Financiar (së paku në baza mujore), me mbështetje formale të raporteve, të cilat shpjegojnë arsyet për ndonjë mospajtim të identifikuar;
- Gjithashtu duhet të sigurohet se të gjitha shtojcat e kontratës për punët shtesë të arrihen në kuadër të limitit të vendosur sipas ZJN. Për punët shtesë që tejkalojnë 10% të kontratës kryesore duhet të vazhdohet me procedurën e re të prokurimit apo të shfrytëzohen hapat e negocimit pa shpalljen e informatave për dhënie të kontratës. Organet mbikëqyrëse të projektit duhet ta forcojnë kontrollin dhe të konfirmojnë vetëm sasitë reale dhe cilësinë e punëve;

- Kryetari i Komunës duhet t'ua bëjë me dije zyrtarëve për financa dhe prokurim publik se kontratat duhet të respektohen rreptësisht, dhe se kurrfarë furnizimi apo pagese nuk mund të kryhet jashtë kontratës;
- Përveç kësaj, duhet të sigurohet që të gjitha faturat për drekat zyrtare të bazohen në dëshmitë shtesë mbi qëllimin e organizimit, numrin e pjesëmarrësve dhe që faturat të përmbajnë të dhënat e sakta mbi shumën e paguar;
- Kryetari duhet ta forcojë kontrollin e shpenzimeve për telefoninë fikse dhe atë mobile. Vendimi për mbushje për telefona celularë duhet të precizojë autorizimin për shfrytëzim të tyre si dhe duhet të respektohet secila pikë e këtij vendimi.
- Duhet të ndërmerret një rishikim sistematik i Dosjes së Stafit, për t'u siguruar që aty është i përfshirë i gjithë dokumentacioni i nevojshëm, brenda një afati specifik kohor.
- Pastaj duhet të sigurohet se Rregullorja e Brendshme po respektohet gjatë ndarjes së subvencioneve dhe se të gjitha subvencionet trajtohen në përputhje me procedurat e vendosura në Rregullore, duke përfshirë edhe aspektin e raportimit;
- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet të cilat i plotësojnë kriteret për regjistrim në ISUFK apo në regjistrin e pasurisë të regjistrohen pavarësisht mënyrës së si janë fituar;
- Në një afat kohor optimal, Kryetari duhet të emërojë zyrtarin e posaqëm për pasuri dhe logjistikë. Nevojiten masat e menjëhershme që këta zyrtarë të fillojnë me regjistrimin e pasurisë dhe ta vënë atë nën menaxhim të plotë;
- I rekomandojmë Kryetarit të zhvillojë një strategji të qartë për mënyrën e pagesës së borxheve të pashlyera. Komuna duhet të ketë parasysh dispozicionin e mjeteve para se të hyjë në obligime dhe t'i kryejë pagesat brenda afateve ligjore;
- Me qëllim të forcimit të misionit të auditimit të brendshëm dhe të sistemit të kontrollit në përgjithësi, Komisioni i auditimit i rekomandon Kryetarit, që brenda një afati kohor, të marrë parasysh themelimin e Komisionit të Auditimit të Brendshëm.

- Kryetari i Komunës do të duhej të siguronte që të kryhen përputhja e stafit
- për gjënerimin e të hyrave dhe e stafit të Shërbimit Financiar (së paku
- në baza mujore), me mbështetje formale të raporteve, të cilat shpjegojnë
- arsyet për ndonjë mospajtim të identifikuar;

Sipas Raportit të Auditorit Gjeneral, Komuna e Shtërpçës në vitin 2014 ka planifikuar të shpenzojë gjithsej 1,212,822 € për investime kapitale, mallra dhe shërbime . Nga shuma e parashikuar, gjithsej janë shpenzuar 1,099,314€. Dallimi prej 113,508€ ka mbetur i pashfrytëzuar.

AUDITIMI

Në bazë të raportit të Auditorit Gjeneral kemi ardhur në përfundim se mangësitë e prokurimit publik dhe të shërbimeve janë si vijon:

- Raportet vjetore financiare nuk janë të plota;
- Korniza menaxhuese është përcjellur me mangësi sa i përket raportimit formal dhe kualitativ të aktiviteteve financiare dhe operacionale;
- Ka mangësi të theksuara në fushën e shpenzimeve, përfshirë edhe prokurimin publik;

REKOMANDIMI I RAPORTIT TË AUDITORIT ËSHTË SI VIJON:

- Kryetari i Komunës duhet t'i analizojë shkaqet për deklarimin e gabueshëm fillestar të pasurisë dhe për shpërfilljen e këshillave të ZAP-it në fazën kalimtare për adresimin e tyre. Duhet të ndërmerren masat adekuate që të sigurohet pasqyrimi i saktë i pasurisë në Raportin vjetor financiar për vitin 2014 së bashku me funksionimin me kohë dhe efikas të Komisionit për Inventarizim;
- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i rishikuar i veprimit të definojë saktë afatin kohor për adresimin e rekomandimeve të ZAP-it, së bashku me anëtarët e identifikuar të stafit përgjegjës, me fokus fillestar në pikat e


rëndësisë më të madhe. Plan i veprimit duhet të rishikohet nga ana e Kryetarit të Komunës në baza tremujore;

- Kryetari i Komunës duhet të zhvillojë një rishikim për të vendosur formën e raportimit financiar të menaxhmentit të lartë, që është edhe kërkesë për mbështetjen e menaxhimit efikas të punës, Kjo duhet të mbështetet nga një strukturë menaxheriale ku menaxhmenti i lartë është i informuar me mangësitë e kontrollit dhe t'i drejtojë ato në mënyrë më aktive;
- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procesit të buxhetimit t'i paraprijë një proces rigoroz i vlerësimit i cili i pasqyron plotësisht informacionet duke përfshirë edhe shpenzimet e vitit paraprak/sfidat potenciale gjatë vitit e kështu me radhë. Fokusi i veçantë duhet të orientohet drejt identifikimit të pengesave dhe mundësive për ngritjen e nivelit të ekzekutimit të projekteve kapitale, si dhe duhet të ndërmerren hapat e duhur për adresimin e këtyre pengesave dhe të shfrytëzohen mundësitë e identifikuar. Mbikëqyrja efektive gjatë vitit buxhetor duhet të realizohet kur ndërmerret një veprim për adresimin e dallimeve karshi buxhetit të planifikuar.
- Kryetari i Komunës duhet të bëjë rishikime sistematike me qëllim të identifikimit të ndërmarrjeve aktive në Komunë dhe të sigurojë se të gjitha këto ndërmarrje kanë leje për veprimtari dhe faturohen për tatime për vitin 2014;
- Kryetari i Komunës duhet të kryej kontroll të brendshëm;
- Kryetari i Komunës duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe me Qeverinë;
- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë themelimin e Komisionit për Auditim.

Kontratat e nënshkruara nga Komuna e Shtërpçës përmes procedurave të prokurimit publik

Komunës i është bërë kërkesë për qasje në dokumente publike, kësaj radhe me qëllim të sigurimit të të dhënave për numrin e tenderëve të planifikuar në periudhën 2010-2015. Komuna ende nuk është përgjigjë në kërkesë.

Sa i përket tenderëve të realizuar në periudhën 2010-2015, nga të dhënat që janë marrë nga web faqja e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) janë gjetur rezultatet në vijim.



Gjatë periudhës 2010-2015 ne kemi gjetur që KK Shtërpçë, ka hapur 179 procese të tenderimit, nga këto 111 kanë qenë tenderë të llojit “punë”, 41 tenderë të llojit “furnizim” dhe 27 tenderë të llojit “shërbime”

2010 Për vitin 2010 Komuna e Shtërpçës ka shpalur 22 procese të prokurimit nga të cilat 18 kanë qenë të llojit “punë”, dy të llojit “furnizim” dhe dy të llojit “shërbime”

2011 Për vitin 2011 Komuna e Shtërpçës ka shpalur 34 procese të prokurimit nga të cilat 24 kanë qenë të llojit “punë”, gjashtë të llojit “furnizim” dhe katër të llojit “shërbime” në fushën e “shërbimeve”;

2012 Për vitin 2012 Komuna e Shtërpçës ka shpalur 26 procese të prokurimit nga të cilat 17 kanë qenë të llojit “punë” dhe nëntë të llojit “furnizim”

2013 Për vitin 2013 Komuna e Shtërpçës ka shpalur 37 procese të prokurimit nga të cilat 31 kanë qenë të llojit “punë”, pesë të llojit “furnizim”, dhe një të llojit “shërbime”


2014 Për vitin 2014 Komuna e Shtërpçës ka shpalur 37 procese të prokurimit nga të cilat 16 kanë qenë të llojit “punë”, 11 të llojit “furnizim” dhe dhjetë të llojit “shërbime”

2015 Për vitin 2015 Komuna e Shtërpçës ka shpalur 23 procese të prokurimit pesë kanë qenë të llojit “punë”, tetë të llojit “furnizim” dhe dhjetë të llojit “shërbime”.

Në bazë të 179 tenderëve të analizuar është llogaritur se për periudhën 2010-2015 për 179 tenderë janë shpenzuar gjithsej **€17,105,059**



MJETET E SHPENZUARA PËRMES PROKURIMIT PUBLIK



Siç mund të shihet në grafikonin më lartë në vitin 2012 është shpenzuar më së shumti përmes procedurave të prokurimit publik. Edhe pse numri i tenderëve në vitet në vijim është rritur, vlera e parasë publike të shpenzuar përmes prokurimit publik ka pasur rënie drastike.

2010 Në vitin 2010 Komuna e Shtërpçës në fushën e “punëve” për 18 projekte ka shpenzuar 4,191,749 €, në fushën e “furnizimeve” për dy projekte ka shpenzuar 69,995€, dhe në fushën e “shërbimeve” për dy projekte ka shpenzuar 19,900€;

2011 Në vitin 2011 Komuna e Shtërpçës në fushën e “punëve” për 24 projekte ka shpenzuar 3,297,340 €, në fushën e “furnizimeve” për gjashtë projekte ka shpenzuar 127,650€, dhe në fushën e “shërbimeve” për katër projekte ka shpenzuar 100,708€;

2012 Në vitin 2012 Komuna e Shtërpçës në fushën e “punëve” për 17 projekte ka shpenzuar

2,547,544€, në fushën e “furnizimeve” për nëntë projekte ka shpenzuar 3,154,159€;

2013 Në vitin 2013 Komuna e Shtërpçës në fushën e “punëve” për 31 projekte ka shpenzuar 2,139,199 €, në fushën e “furnizimeve” për pesë projekte ka shpenzuar 163,480 €, dhe në fushën e “shërbimeve” ka pasur një projekt për të cilin nuk kemi të dhëna për vlerën totale;

2014 Në vitin 2014 Komuna e Shtërpçës në fushën e “punëve” për 16 projekte ka shpenzuar 817,886 €, në fushën e “furnizimeve” për 11 projekte ka shpenzuar 103,982 €, dhe në fushën e “shërbimeve” për dhjetë projekte ka shpenzuar 56,833 €;

2015 Në vitin 2015 Komuna e Shtërpçës në fushën e “punëve” për pesë projekte ka shpenzuar 108,693€, në fushën e “furnizimeve” për tetë projekte ka shpenzuar 152,654€, si dhe në fushën e “shërbimeve” për dhjetë projekte ka shpenzuar 53,287€;

Kompanitë që fituan më së shumti tenderë nga KK Shtërpçë

Nga 179 tenderë të kontrolluar, pesë kompani kanë marrë 70 tenderë, apo rreth 39% të tenderëve.


Kompania që ka marrë numrin më të madh të tenderëve është kompania “Luboteni” nga Shtërpça me 23 tenderë.

Ajo ka përfituar gjithsej 23 tenderë, nga të cilët 21 janë në fushën e “punëve” për të cilët janë shpenzuar 1,111,872€, një në fushën e “shërbimeve” për të cilin janë shpenzuar

19,900 €, dhe 1 në fushën e “furnizimeve” për të cilin nuk kemi vlerën përfundimtare.

Kompania e dytë sipas numrit të tenderëve është “Linda” nga Ferizaji. Ajo ka përfituar gjithsej 19 tenderë nga të cilët 18 janë në fushën e “punëve” për të cilët është shpenzuar 3,444,946€, dhe një tender është në fushën e “shërbimeve” për të cilin janë shpenzuar 9,990 €.

KOMPANITË QË FITUAN MË SË SHUMTI TENDERË



Kompania e tretë është “Rilinda Company” nga Shtërpca. Ajo ka përfituar 12 tenderë. Të gjithë tenderët kanë qenë në fushën e “punëve” për të cilët janë shpenzuar 601,916€.

Kompania e katërt sipas renditjes është “Lirija” nga Shtërpca. Ajo ka përfituar tetë tenderë në fushën e “punëve” për të cilët janë shpenzuar 286,503€.


Kompania e pestë me radhë sipas numrin të tenderëve të fituar është “Euro-Genti” nga Shtërpca. Ajo ka përfituar tetë tenderë, nga të cilët shtatë kanë qenë në fushën

e “punëve” për të cilët janë shpenzuar 170,279€, dhe një tender në fushën e “shërbimeve” me vlerë prej 42,430€.

Nga 17,105,059 euro të shpenzuara përmes prokurimit publik, pesë kompani kanë fituar 11,356,937 euro përmes 60 tenderëve.

Nga vlera totale e shpenzimeve përmes prokurimit publik, këto pesë kompani kanë fituar 66.4% të të gjitha mjeteve, për dallim nga pjesa tjetër e kompanive që kanë fituar vetëm 5,748,122 euro

KOMPANITË QË KANË FITUAR MË SË SHUMTI TENDERË SIPAS VLERËS



Edhe pse kompania “Luboteni” ka fituar madje 23 tenderë, në vendin e parë për nga vlera e tenderëve qëndron kompania “Albes” e cila ka përfituar tenderë në vlerë 5,904,643€ Kompanitë tjera që kanë fituar vlerë më të madhe nga ten-

derët janë “Linda” me vlerë 3,454,936 €, “KosovaMed” me vlerë 3,127,950 €, “Luboteni” me vlerë 1,395,440€ dhe “Rilinda Company” me vlerë prej 601,918 €.

RAPORTET E AUDITIMIT

2010

Në bazë të dokumentacionit të shikuar për Komunën e Shtërpçës sa i përket vitit 2010, ZAP-i ka vërejtur problemet në vijim:

- Komuna nuk ka paraqitur në raport grantin e qeverisë që e ka pranuar KKB;
- Komuna nuk ka paraqitur në raport informacione në lidhje me fondet e saj bazike;
- Komuna nuk ka vendosur procedura efikase të prokurimit publik në përputhje me rregullat ekzistuese të prokurimit, dhe si rezultat i kësaj auditorët kanë vërejtur një sërë parregullsish siç janë:
 - Aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar pa rezervim paraprak të mjeteve në sistemin Free Balance
 - Ka pasur parregullsi në menaxhimin e kontratave të prokurimit;
- Në Komunën e Shtërpçës ka edhe disa raste të prokurimit publik për investime kapitale dhe shpenzime operationale të cilat i ka zhvilluar Komuna, ku data e nënshkrimit të kontratës me furnizuesin është më e hershme se data e rezervimit të mjeteve në sistemin Free Balance. Kjo nënkupton se komuna ka shpallur tenderë dhe ka përzgjedhur operatorë fitues pa rezervim paraprak të mjeteve në sistemin Balance;
- Gjithashtu, Komuna ka hyrë edhe në borxhe tjera;
- Të hyrat kapitale (lloji i pasurisë, fondi i privatizimit, lloji i të hyrave) – Komuna nuk ka evidentuar asnjë nga këto aktivitete;
- Është vërejtur tejkalimi i buxhetit të mjeteve vetanake, tejkalimi të programet e caktuara buxhetore siç është shëndetësia ku nuk kanë arritur të punësojnë staf të parashikuar me këtë buxhet. Gjithashtu, në programin për zjarrfikës është llogaritur numri më i madh i punëtorëve se numri aktual i atyre që punojnë;
- Rregullimi i oborrit të kishës Sv. Dimitrije Donja Bitinja; Rregullimi i hapësirës së kishës Sv. Todor Donja Bitinja; Rindërtimi i ujësjellësit Gornja Bitinja; Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Gornja Bitinja. Këtu katër projekte kapitale nuk janë paguar si rezultat i gabimit teknik në xhirollogarinë e klientit e cila ka qenë joaktive;
- Në bazë të evidencës të cilën e posedon menaxheri për taksa të biznesit, borxhet e subjekteve të biznesit nga vitet paraprake janë 29.716 €.
- Rrogat e stafit politik të Komunës janë për 10% më të larta sesa duhet të jenë.

2011

Gjatë vitit 2011 Komuna nuk ka trajtuar në mënyrë të duhur rekomandimet që kanë dalur nga raporti i auditorit për vitin 2010. Komuna nuk ka përgatitur një plan për adresim, dhe asnjë prej rekomandimeve nuk është adresuar

- Komuna e Shtërpcës nuk e ka zbardhur plotësisht dhe saktësisht informacionin për pasurinë. Të gjeturat e auditorit për vitin 2011 po përsëriten që nga viti 2007 dhe me gjithë rekomandimet adekuate për përmirësim, ndryshimet pozitive nuk janë vërejtur. Mungesa e zyrtarit për pasurinë i cili do të krijonte një regjistër të plotë të pasurisë dhe ta përditësonte vazhdimisht, mund të nënkuptojë edhe mungesë të kontrollit dhe mangësi sa i përket menaxhimit të pasurisë. Komuna nuk ka përgatitur ndonjë plan për adresimin e rekomandimeve të vitit 2010 dhe nuk ka ndërmarrë masa të duhura për raportimin e pasurisë në vitin 2011.

- Në raportin e auditorit lidhur me Raportin vjetor financiar për vitin 2010 janë dhënë 4 rekomandime. Asnjëra nga këto rekomandime nuk është zbatuar në vitin 2011. Fakti se asnjë nga rekomandimet nuk është adresuar tregon mungesën e kontrollit të performancës si dhe mosgatishmërinë e menaxhmentit për të ndërmarrë hapa drejt përmirësimit.

Sa i përket të hyrave vetanake:

- Nuk janë barazuar të hyrat vetanake ndërmjet departamenteve dhe zyrtarëve të të hyrave; dhe
- Nuk janë kryer pagesat e të hyrave të inkasuara në baza ditore në bankë;
- Komuna nuk ka pasur Plan përfundimtar të prokurimit publik për vitin 2011. Përveç kësaj, mungon edhe Rregullorja për ndarjen e subvencioneve;

- Fakti se asnjë nga rekomandimet nuk është adresuar tregon mungesën
- e kontrollit të performancës si dhe mosgatishmërinë e menaxhmentit
- për të ndërmarrë hapa drejt përmirësimit.

Sa i përket vitit 2012 Komuna e Shtërpcës nuk i ka kush-tuar vëmendje të duhur implementimit të rekomandimeve të auditorit. Auditorët kanë identifikuar planifikim të keq të të hyrave vetanake.

- Është identifikuar një varg mangësish në fushën e prokurimit publik. Prokurimi pa kontrata dhe niveli i ulët i mbikëqyrjes janë disa nga mangësitë ekzistuese të procesit. Komuna e Shtërpcës ka nënshkruar marrëveshje për ndërtimin e spitalit në Shtërpcë, dhe me këtë rast Komuna ka nënshkruar një aneks-kontratë për punët shtesë të cilët nuk janë në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik, janë tejkaluar shumat dhe anekset janë bërë jashtë procedurave të prokurimit. Komuna ka nënshkruar marrëveshje me EO „Atom Med” për furnizim me pajisje dhe materiale shëndetësore për Shtëpinë e Shëndetit në Shtërpcë, por është zbuluar tejkalimi i shumës së kontraktuar dhe kjo konsiderohet pagesë e parregullt;
- Mungesa e kontrollit është vërejtur edhe në rastet tjera. Shpenzimet e telefonit dhe shpenzimet për dreka nuk janë arsyetuar me dëshmi adekuate, dhe kjo paraqet rrezik që komuna shpenzon mjete publike pa dëshmi të duhura;
- Është vërejtur mungesa e dokumentacionit komplet për ndarje të subvencioneve. Komuna nuk arrin marrëveshje mirëkuptimi me shfrytëzuesit e subvencioneve sa i përket mënyrës së shpenzimit dhe raportimit nga ana e përfituesve;
- Menaxhimi i keq me detyrimet. Janë paguar mbi 1,2 milion euro borxhe të pashlyera nga viti 2011, dhe kanë mbetur më shumë se 1 milion euro borxhe të papaguara.
- Gjendja e menaxhimit të pasurisë në Komunë është joadekuate. Ka mungesë të zyrtarit të pasurisë, zyrtarit për logjistikë dhe inventarizim joefikas. Evidentimi i pasurisë me vlerë më të vogël se 1,000€ në pronësi të Komunës nuk është bërë në shumta të plota. Rreziku i paraqitjes së pasaktë të pasurisë çon deri te keqkuptimi i pozitës financiare të Komunës, si dhe krijon hapësirë për keqkuptime sa i përket kërkesave buxhetore të Komunës në të ardhmen. Për më tepër, është i pamundur menaxhimi efikas i pasurisë;
- Ka vonesa sa i përket grumbullimit të të hyrave nga tatimet në pronë. Gjithashtu ka raste dhe periudha në të cilat nuk ka pasur përputhje të të hyrave vetanake ndërmjet departamenteve të cilat bëjnë grumbullimin e të hyrave në një anë dhe Ministrisë së Financave në anën tjetër;
- Edhe pse auditorët në vitin 2011 kanë identifikuar një varg mangësish që kanë të bëjnë me shpenzimet, ku janë dhënë edhe rekomandimet gjegjëse, është e qartë se Komuna nuk ka arritur ta kuptojë nevojën për kontroll më të rreptë të sistemit në këtë fushë;
- Përveç kësaj, ka raste kur Komuna ka paguar gabimisht dy herë borxhin e njëjtë i cili ishte i grumbulluar për telefoninë fikse;
- Auditorët gjithashtu kanë zbuluar se dosjet fizike të punëtorëve të Komunës së Shtërpcës janë të pakompletuara në bazë të Udhëzimit Administrativ. Në disa raste mungojnë kopjet e letërnjoftimeve, diplomat e arsimit si dhe llogaritjet e pushimit vjetor. Në të gjitha dosjet e shikuara mungonin kopjet e llogarisë bankare. Poashtu, Komuna e Shtërpcës nuk mban evidencë elektronike të punëtorëve;

2013

Në vitin 2013 ende ekzistojnë problemet e njëjtë sa i përket regjistrimit të pasurisë e cila është në pronësi të Komunës, dhe që ende nuk është e identifikuar dhe e regjistruar në mënyrë të duhur, duke rezultuar me anomali materiale tek shënimet e pasurisë nëpër Raporte financiare.

- Raporti i auditorit për Raportin vjetor financiar për vitin 2012 ka rezultuar me 14 rekomandime kryesore. Nga këto, janë adresuar plotësisht vetëm 7 rekomandime, 5 kanë qenë në proces të adresimit dhe 2 nuk janë adresuar fare;
- Mangësitë e zakonshme në procesin e prokurimit publik janë si vijon:
- Më shumë se 30% të faturave të operatorëve ekonomikë nuk janë paguar
- Në dy kontrata: „Meremetimi i rrugës Markagine” dhe „Asfaltimi i rrugës Jazine – Svece” nuk ka pasur mjete të mjaftueshme të zotuar për përmbushjen e marrëveshjes, si dhe nuk ka pasur licencë për sigurimin e bazës për asfalt;
- Në katër projekte vlera totale e të cilëve arrin 25,684€, punët janë kryer pa procedura prokurimi dhe pa nënshkrim të ndonjë kontrate të punës ndërmjet Komunës dhe Operatorit ekonomik;

Gjithashtu, disa projekte nuk kanë pasur raport për pranim të punëve

- Proceset tjera të prokurimit janë përcjellur me mangësi specifike të kontrollit. Në kontratën e datës 22.08.2012 për furnizim me karburante, operatori i ka rritur çmimet në fatura pa ndonjë dëshmi për ndryshim të çmimeve në bursa;
- Ka pasur ndarje të subvencioneve pa kurrfarë marrëveshjes të shkruara dhe pa dëshmi se si janë shpenzuar ato mjete;
- Gjatë vitit 2010 komuna ka bërë marrëveshje për ndërtimin e objekteve për strehimin e personave të cilët ishin të vendosur nëpër hotele (1,862,955€), si dhe i (1,382,171€) për ndërtimin e spitalit në Shtërpçë, por këto nuk janë realizuar.

2014

Njëjtë si në vitet paraprake, gjithashtu në vitin 2014 ka pasur një varg parregullsisht, duke filluar nga mosdeklarimi i pasurisë, e deri te paraqitja e pakompletuar dhe e pasaktë e gjendjes së pasurisë së Komunës.

- Raportet vjetore financiare janë të pakompletuar, për shembull, te listat e pagave është vërejtur se arsimtarët e nivelit të njëjtë, me fond të njëjtë të orëve, dhe me kualifikim të njëjtë në një shkollë paguhen me pagën prej 382 €, ndërsa në shkollën tjetër me pagën prej 519 €. Ky dallim ekziston pasi në një shkollë merren parasysh kualifikimet dhe ora e punës, derisa në shkollën tjetër këto nuk merren për bazë.
- Vetëm 1 nga 13 rekomandimet nga viti paraprak është adresuar plotësisht në vitin 2014;
- Ka pasur ndarje të subvencioneve pa rregullore të brendshme dhe pa raporte kthyes nga ana e përfituesve të subvencioneve;

- Niveli total i realizimit të buxhetit ka qenë 88%. Buxheti për investimet kapitale, në bazë të vendimeve gjyqësore, është realizuar në nivelin prej 47%.
- Gjithashtu, Komuna nuk ka themeluar Komisionin për Auditim;
- Ekzistojnë mangësi të theksuara në fushën e shpenzimeve, duke përfshirë edhe prokurimin publik:
 - Janë arritur marrëveshje për shërbime të kujdesit shëndetësor dhe ndihmës profesionale për spital në vlerën prej 350 euro në muaj, për periudhën nga 20.06.2014 deri 31.12.2014, e nuk ka ndonjë dëshmi nëse janë kryer këto shërbime;
 - Në rastet që kishin të bënin me shfrytëzimin e veturave private për çështje zyrtare, janë paguar 506 litra karburante, pa kurrfarë dëshmish se vetura vërtetë është shfrytëzuar për nevojë zyrtare;
 - Për "Pastrimin e rrugës Vrbeštica" Komuna ka paguar shumën prej 6,900€ pa kontratë paraprake, por si rezultat i nevojës së menjëhershme për pastrim;

KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Numri i ankesave
në KRPP

2

Të tërhequra
nga ana e
ndërmarrjeve

1

Të refuzuara

/

Të miratuara
pjesërisht

1

Të miratuara

/

Në periudhën 2010-2015 në adresën e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik kanë ardhur 2 ankesa të cilat pretendonin për mosrespektim të procedurave të ndarjes së tenderëve dhe për parregullsitë e bëra nga ana e Komunës.

Raporti lidhur me këto ankesa për periudhën 2010-2015 tregon se ka pasur 2 ankesa të dorëzuara në KRPP, ku 1 ankesë është tërhequr pasi ankuesi nuk ka arritur të japë

dëshmi të sigurimit të ankesës brenda afatit kohor, derisa ankesa e dytë është miratuar pjesërisht.

Në fakt, pas kësaj ankese aktiviteti është kthyer në fazën e shpalljes së tenderit, pasi paneli për shqyrtim ka konstatuar se ankuesi ka pasur pjesërisht të drejtë sa i përket paratenderimit të ankesës dhe se ishin shkelur dispozitat ligjore.

FINANCIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE

Raportet e auditura të pasqyrave financiare janë të publikuara vetëm për vitet 2009-2012. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk i ka publikuar asnjëherë pasqyrat financiare të SP për vitet para vitit 2009, pasi ato janë audituar nga OSBE.

Ndërsa pasqyrat financiar të SP politike pas vitit 2013 nuk janë të audituara sepse Kuvendi i Kosovës ka dështuar të përzgjedhë kompaninë për auditim.

Kuvendi Komunal i Graçanicës gjatë viteve 2007-2015 është udhëhequr në dy mandate nga SLS dhe në një mandat nga PDK.

SLS gjatë viteve 2009-2012 ka deklaruar vetëm një donacion të jashtëm në vlerë 3,000 euro. Ky donacion është pranuar brenda ditës dhe është në kundërshtim me kërkesat nga neni 5 i Rregullores 2004/2 mbi ("Shpërlarjen e parave"); përkatësisht- Ligji Nr. 03/L-196 për Parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

PDK gjatë viteve 2009-2012, ka pranuar në formë donacioni 502,084 euro nga persona fizik dhe juridik.

Në shumë raste auditori ka gjetur tejkalim të shpenzimeve gjatë fushatave zgjedhore, dhe tejkalim të limitit për pranimin e donacioneve brenda ditës.


LIDHJET E BIZNESIT ME POLITIKËN

Nga të dhënat e nxerrura nga KRPP dhe të dhënat e pasqyrave financiare të SP, kemi arritur të identifikojmë pesë kompani të cilat kanë financuar SP dhe që kanë marrë tenderë nga KK Shtërpçë.

Katër nga këto kompani kanë financuar PDK, e cila për një kohë të gjatë ka qenë në koalicion me SLS në nivelin qendror. Një kompani ka financuar subjektin politik AKR.

Këto pesë kompani përmes 11 tenderëve kanë fituar 114,482 euro nga KK Shtërpçë

VLERA E TENDERËVE TË FITUAR NGA KOMPANITË QË FINANCUAN SP



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fillimisht hulumtimi tregon se rekomandimet e Zyrës së Auditorit Gjeneral, nuk janë zbatuar ndër vite. Vetëm në vitin 2013, Zyra e Auditorit Gjeneral kishte bërë 13 rekomandime dhe bazuar në raportin e Auditorit, vetëm njëri nga 13 rekomandimet, ishte adresuar. Gjithashtu nuk janë zbatuar rekomandime të viteve paraprake dhe të vitit 2014.

Bazuar në hulumtimin tonë, Komuna e Shtërpçës del të ketë probleme të shumta në qeverisje sa i përket buxhetit, në veçanti në fushën e prokurimit publik.

Raporti i Auditorit ka identifikuar probleme të shumta të cilat ndikojnë në operimin funksional buxhetor. Në periudhën 2010 – 2015, janë identifikuar probleme duke filluar me shkeljen e dispozitave ligjore të Prokurimit Publik, procedurat jo-efikase të Komunës në prokurimin publik në përputhje me rregullat ekzistuese të prokurimit, lidhjet dhe favoret politike për ndërmarrjet në rastet e ndarjes së tenderëve, kontratat në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik.

Edhe pse Zyra e Auditorit Gjeneral kishte rekomanduar planifikimin e duhur buxhetor, respektimin e dispozitave ligjore të prokurimit publik në rastet e nënshkrimit të kontratave dhe zhvillimit të procedurave tjera të prokurimit publik, një gjë e tillë nuk ishte adresuar nga organet përgjegjëse komunale.

Lidhur me këtë, Zyra e Auditorit Gjeneral kishte rekomanduar krijimin e një komisioni të brendshëm të auditimit dhe marrjen parasysh zbatimin e rekomandimeve, një gjë e tillë nuk është marrë parasysh nga komuna.

Ndër të tjera, Raporti i Auditorit gjithashtu kishte vërejtur parregullsi në menaxhimin e kontratave, mungesë të deklaramit të pasurisë, probleme me shpenzimet, pagesat dhe barazimet, mungesë të dokumentacionit, dëshmime dhe faturave të shpenzimeve, në veçanti për karburantet.

E gjithë kjo kishte shkaktuar probleme të vazhdueshme në funksionimin normal të Komunës sa i përket shpenzimit të parasë publike dhe respektimit të dispozitave ligjore, në veçanti atyre për prokurimin publik.

Zbatimi dhe adresimi i rekomandimeve do të duhej të konsiderohej nevojë urgjente e organeve relevante komunale. Konsiderojmë se identifikimet e Zyrës së Auditorit Gjeneral dhe adresimi i problemeve të tilla nga ana e komunës, do ndihmonte në adresimin e problemeve të shumta ndër vite e dhe gjithashtu do të ndikonte në evitimin dhe mos-përsëritjen e problemeve të tilla në vitet pasuese.

